



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM
PËR REKRUTIMIN E NJË EKSPERTI TË JASHTËM PËR KONCEPTIMIN E
FUSHATËS SË INFORMIMIT, SENSIBILIZIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË
KONSUMATORËVE

TERMAT E REFERENCËS

Për rekrutimin e një eksperti të jashtëm për konceptimin e fushatës së informimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve

Në vitin 2024 është miratuar ligji nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili ka hyrë në fuqi më 20 dhjetor 2024, duke shfuqizuar ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Direktivën (BE) 2018/1972 "Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike" dhe shënon një etapë të re në zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, duke krijuar një kuadër ligjor më modern, konkurrues, inovativ dhe të orientuar drejt mbrojtjes së konsumatorit.

Në këtë kuadër, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) synon të organizojë një fushatë informimi, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për qytetarët dhe subjektet tregtare mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Objektivi i angazhimit

Objektivi i këtij angazhimi është ofrimi i ekspertizës për konceptimin dhe planifikimin e një fushate kombëtare informimi, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi, me qëllim:

- Informimin e konsumatorëve mbi të drejtat dhe garancitë e reja të parashikuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor për komunikimet elektronike;
- Rritjen e ndërgjegjësimin të qytetarëve dhe subjekteve tregtare mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre në fushën e komunikimeve elektronike, shërbimeve postare dhe tregtisë elektronike (online);
- informimin e publikut mbi standardet e cilësisë së shërbimeve postare, të drejtën për informim të plotë dhe transparent nga ofruesit e shërbimeve, procedurat për paraqitjen e ankesave në rast humbjeje, dëmtimi ose vonese të dërgesave, si dhe kushtet dhe procedurat për përfitimin e dëmshpërblimit sipas legjislacionit në fuqi.
-

Produktet e pritshme

Ekspteri do të dorëzojë produktet e mëposhtme, sipas rendit kronologjik:

- Dokumentin konceptual për organizimin e fushatës së informimit, sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe subjekteve tregtare në fushën e komunikimeve elektronike, shërbimeve postare dhe tregtisë elektronike.
- Hartimin e specifikimeve teknike për zhvillimin e procedurës së negocimit në kuadër të realizimit të fushatës.
- Konceptimin e identitetit vizual, linjës grafike dhe elementeve informuese të fushatës.
- Hartimin e projekt-ideve për spotet informuese.
- Përcaktimin e kanaleve dhe mjeteve të komunikimit.
- Hartimin e një plani konkret veprimi, me synim sigurimin e një qasjeje sa më gjithëpërfshirëse dhe efektive të fushatës.
- Identifikimi dhe segmentimi i grupeve të synuara (target audience).
- Hartimi i mesazheve kryesore për secilin grup përfitues.
- Përgatitja e kalendarit të komunikimit dhe publikimeve.
- Përgatitja e udhëzimeve për identitetin vizual (Brand Guidelines).

Të gjitha dokumentet do të dorëzohen në formë elektronike dhe të shkruar në gjuhën shqipe (dhe, nëse kërkohet, edhe në gjuhën angleze).

Angazhimi i ekspertit parashikohet të zgjasë deri në fillim e procedurës për negociimin sipas VKM nr. 1195/2008.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

Ekspteri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në Marketing, Informatikë, Shkenca të Komunikimit, ose fusha të ngjashme që lidhen me komunikimin dhe median digjitale;
- Të paktën 10 vite përvojë profesionale në hartimin, konceptimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit, marketingut, transformimit digjital ose inovacionit.
- Përvojë të dokumentuar në konceptimin dhe menaxhimin e fushatave të informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit publik.
- Përvojë në hartimin e strategjive të komunikimit institucional dhe planeve të komunikimit.
- Përvojë në menaxhimin e komunikimit publik dhe marrëdhënieve me median.
- Përvojë në hartimin dhe zbatimin e fushatave të komunikimit në media tradicionale dhe platforma digjitale.
- Përvojë në zhvillimin e identitetit vizual, materialeve promocionale dhe koncepteve kreative për fushata informuese.
- Përvojë në drejtimin ose koordinimin e projekteve komplekse në institucione publike ose organizata me interes publik.
- Njohuri mbi komunikimin digjital, rrjetet sociale, marketingun online dhe analizën e audiencës.
- Aftësi në hartimin e planeve të veprimit, dhe monitorimin e rezultateve të fushatave.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Pagesa

Pagesa do të kryhet në përputhje me kushtet e kontratës dhe pas dorëzimit dhe miratimit të produkteve përkatëse nga AKEP.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Shprehje interesi për aplikim në thirrjen "Për rekrutimin e një eksperti të jashtëm për nevojat e AKEP";
2. Kopje të diplomës universitare në Marketing, Informatikë, Shkenca të Komunikimit, ose fusha të ngjashme që lidhen Diplomë universitare në Marketing, Informatikë, Shkenca të Komunikimit, ose fusha të ngjashme që lidhen me komunikimin dhe median digjitale;
3. Dokumentacion që provon përvojën profesionale dhe punët e ngjashme të realizuara;
4. Dokumentacion që vërteton eksperiencën profesionale (libreza e punës ose dokumente ekuivalente);
5. Propozim teknik dhe financiar, ku të paraqiten afatet dhe kushtet financiare për realizimin e angazhimit;
6. Jetëshkrim (CV);
7. Kopje të dokumentit të identifikimit (ID ose pasaportë).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Diploma e shkollës së lartë;	30 pikë
Përvojë profesionale/ekspertizë vërtetuar me dokumentacion përkatës;	40 pikë
Propozim mbi afatet dhe kushtet financiare;	20 pikë
Jetëshkrimi;	10 pikë

Përbën avantazh:

- Përvojë në institucione publike, autoritete rregullatore ose organizata ndërkombëtare.
- Përvojë në sektorët e komunikimeve elektronike, shërbimeve postare, teknologjisë së informacionit ose transformimit digjital.
- Përvojë në konceptimin e fushatave kombëtare të informimit dhe ndërgjegjësimit.
- Përvojë në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian ose donatorë ndërkombëtarë.
- Portofol i dokumentuar i fushatave të realizuara dhe referenca profesionale.
- Certifikime profesionale në marketing dixhital, komunikim strategjik ose menaxhim projektesh.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 12 Gusht, në adresën Rr. Reshit Collaku, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AKEP.